



RAPORT MONITORIMI JANAR – QERSHOR 2025

Strategjia Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit 2024 – 2030

www.drejtesia.gov.al

Tabela e Përmbajtjes

Tabela e Përmbajtjes	2
I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE MBI MONITORIMIN E STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE PËR MBROJTJEN E VIKTIMAVE TË KRIMIT DHE PLANIT TË VEPRIMIT 2024 – 2030, PËR PERIUDHËN JANAR – QERSHOR 2025.	6
II. METODOLOGJIA E MONITORIMIT	110
III. PROGRESI I ZBATIMIT SIPAS QËLLIMEVE.....	11
I. Qëllimi i Parë i Politikës	12
II. Qëllimi i Dytë i Politikës.....	16
III. Qëllimi i Tretë i Politikës.....	18
IV. Qëllimi i Katërt i Politikës.....	18
IV. KONKLUZIONE	
V. SFIDAT	Error! Bookmark not defined.

SHKURTIME

AAPSK	Agjencia e Administrimit të Pronave të Sekuestruara dhe të Konfiskuara
AKR	Agjencia Kombëtare e Rinisë
AKSHI	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
AMA	Autoriteti Mediave Audiovizive
AMVV	Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjen Vendore
AP	Avokati i Popullit
AS	Akademia e Sigurisë
ASCK	Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Kujdesit Shëndetësor dhe Shoqëror
ASHDMF	Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës
BE	Bashkimi Evropian
CPT	Komiteti për Parandalimin e Torturës
QKEDH	Qendra Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm
DNJF	Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas
DPB	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve
DPP	Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit
DPPSH	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
DPSHP	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës
DAP	Departamenti i Administratës Publike
DHASH	Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë
DHKN	Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve
GREVIO	Grupi i Ekspertëve të Këshillit të Evropës për Masat kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje
GRETA	Grupi i Ekspertëve mbi Veprimin kundër Trafikimit të Qënieve Njerëzore
GjEDNj	Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
IAL	Institucione të Arsimit të Lartë
IML	Instituti i Mjekësisë Ligjore
INSTAT	Instituti i Statistikave të Republikës së Shqipërisë
KDIMDP	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale
KDPM	Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur

KP	Kodi Penal
KPP	Kodi Procedurës Penale
KiE	Këshilli i Evropës
KKBDF	Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve
KMD	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi
KL GJ	Këshilli i Lartë Gjyqësor
KLP	Këshilli i Lartë i Prokurorisë
KM	Këshilli i Ministrave
MAS	Ministria e Arsimit dhe Sportit
MSA	Marrëveshja e Stabilizim Asociimit
MB	Ministria e Brendshme
MD	Ministria e Drejtësisë
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MSHRF	Ministër i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
MEVPJ	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
M&V	Monitorim dhe Vlerësim
NJVV	Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore
OJF	Organizata Jo Fitimprurëse
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OSHC	Organizata të Shoqërisë Civile
OZHQ	Objektiva të Zhvillimit të Qëndrueshëm
PBA	Programi Buxhetor Afatmesëm
PKIE	Plani Kombëtar të Integritetit Evropian
PP	Prokuroria e Përgjithshme
PV	Plani i Veprimit
PMF	Punonjësi i Mbrojtjes së Fëmijës
QPKMR	Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve
QTI	Qendra e Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë
RSH	Republika e Shqipërisë
RTSH	Radio Televizioni Shqiptar

SASPAC	Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dh e Koordinimit të Ndhmës
SPAK	Struktura e Posaçme Kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit
SthCh	Save the Children
SHM	Shkolla e Magjistraturës
SHSSH	Shërbimi Social Shtetëror
TdH	Terre des Homes
UEM	Urdhri Evropian i Mbrojtjes
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
UP	Urdhri i Psikologut
UPS	Urdhri i Punonjësit Social
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE MBI MONITORIMIN E STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE PËR MBROJTJEN E VIKTIMAVE TË KRIMIT DHE PLANIT TË VEPRIMIT 2024 – 2030, PËR PERIUDHËN JANAR – QERSHOR 2025.

Kuadri strategjik

Strategjia Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit (SNMVK) 2024–2030 është miratuar me vendimin nr. 729, datë 13.12.2023, të Këshillit të Ministrave. Dokumenti strategjik është në përputhje me **Strategjinë e Bashkimit Evropian për të Drejtat e Viktimave 2020–2025**, si dhe me *acquis* të BE-së në fushën e mbrojtjes së viktimave.

SNMVK synon fuqizimin e pozitës së viktimave në sistemin penal, duke garantuar informimin e tyre, aksesin në drejtësi dhe marrjen e shërbimeve të nevojshme për rehabilitim. Njëkohësisht, theksi vihet tek parandalimi i riviktimizimit dhe viktimizimit të dytë.

Strategjia është pjesë e angazhimeve të ndërmarra në kuadr të procesit të integritetit të vendit në Bashkimin Evropian, si dhe të Kapitulli 23, me fokus përmirësimin e legjislacionit për të drejtat e viktimave dhe forcimin e pozitës së tyre në sistemin e drejtësisë penale.

Koordinimi dhe përputhshmëria me dokumente të tjera

Për zbatimin e SNMVK është siguruar koordinim ndërinstitucional dhe bashkëpunim ndërmjet autoriteteve vendore dhe ndërkombëtare, duke u ofruar viktimave mbështetjen e nevojshme. Strategjia lidhet drejtpërdrejt me:

- Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë;
- Strategjinë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda;
- Planin e Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave;
- Dokumenta të tjerë strategjik në fushën e mbrojtjes së viktimave të krimit

SNMVK është gjithashtu në përputhje me **Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm 2030** dhe agjendën e integritetit evropian të Shqipërisë

Plani i Veprimit 2024–2030

Plani i Veprimit, që shoqëron zbatimin e strategjisë, përmban:

- 4 Qëllime politike
- 11 objektiva strategjike;
- 48 masa;
- 203 aktivitete.
- 18 indikatorë (Pasaporta e Indikatorëve);

Raporti i Monitorimit Janar–Qershor 2025

Raporti gjashtëmuor i monitorimit për periudhën janar–qershor 2025 është **raporti i tretë** mbi zbatimin e SNMVK 2024–2030. Me vendimin nr. 66 datë 15.11.2024, është miratuar raporti janar–qershor 2024 dhe me vendimin nr. 58 datë 21.05.2025, është miratuar raportiv vjetor për 2024.

- Gjatë kësaj periudhe, kanë nisur zbatimin 145 aktivitete dhe 39 masa nga institucionet përgjegjëse.
- Procesi i raportimit është realizuar nga pikat e kontaktit të institucioneve përkatëse, ndërsa Ministria e Drejtësisë ka kryer vlerësimin përfundimtar të informacionit gjatë muajve gusht–shtator 2025

Nga vlerësimi i përgjithshëm për periudhën janar–qershor 2025 rezulton se janë ndërmarrë hapa të rëndësishëm në drejtim të zbatimit të masave të Planit të Veprimit. Monitorimi evidenton progresin e arritur, arritjet kryesore dhe sfidat që mbeten për përmbushjen e plotë të objektivave strategjike të SNMVK 2024–2030.

Zbatueshmëria e SNMVK në nivel masash për janar-qershor 2025

	Plotësisht të zbatuara	Pjesërisht të zbatuara	Të pazbatuara
QP I	3	3	0
QP II	1	12	0
QP III	5	6	3
QP IV	5	1	0

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE





4 QËLLIME POLITIKE, 11 OBJEKTIVA SPECIFIKË 43 MASA TË ZBATUESHME GJATË PERIUDHËS JANAR-QERSHOR 2025

Qëllimi i Parë i Politikës: Fuqizimi i parandalimit dhe raportimit të krimit përmes informimit, ndërgjegjësimit dhe komunikimit efektiv me publikun dhe viktimave të krimit

Qëllimi i Dytë i Politikës: Një kuadër ligjor i përafëruar me standardet e parashikuara në direktivat e Bashkimit Evropian dhe aktet ndërkombëtare të tjera, institucione dhe profesionistë që ofrojnë mbështetje, mbrojtje efektive për viktimat e krimit dhe akses të drejtë të viktimës në një skemë kombëtare të kompensimit

Qëllimi i Tretë i Politikës: Garantimi i të drejtës për informim, mbështetje dhe mbrojtje të viktimave në proceset penale dhe njohja e viktimave me nevoja mbrojtjeje të veçantë

Qëllimi i Katërt i Politikës: Forcimi i bashkëpunimit dhe koordinimit mes aktorëve që veprojnë në fushën e mbrojtjes së viktimave të krimit në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar



DRAFT

II. METODOLOGJIA E MONITORIMIT

Procesi i Hartimit të Raportit

Hartimi i raportit për periudhën janar–qershor 2025 është rezultat i një procesi të strukturuar dhe gjithëpërfshirës të monitorimit, i ndërtuar për të siguruar një analizë të qartë mbi progresin, sfidat dhe rekomandimet për përmirësim. Metodologjia është konceptuar për të garantuar transparencë, objektivitet dhe përfaqësim të saktë të të dhënave.

Ministria e Drejtësisë ka zhvilluar komunikime të rregullta me institucionet përgjegjëse, përmes shkëmbimeve zyrtare dhe takimeve të drejtpërdrejta, duke mbledhur informacion mbi ecurinë e zbatimit të aktiviteteve. Ky bashkëpunim ka bërë të mundur identifikimin e praktikave të suksesshme dhe paralelisht, të sfidave që kanë ndikuar në progresin e strategjisë.

Qasja e ndjekur synon jo vetëm të analizojë të dhënat në mënyrë objektive, por edhe të ofrojë një bazë solide për rekomandime, duke e kthyer raportin në një instrument vendimmarrës dhe një mekanizëm për forcimin e transparencës dhe llogaridhënies.

Koordinimi Institucional

Në zbatim të urdhrit të Kryeministrit nr. 128, datë 08.11.2021, përgjegjës për procesin e monitorimit është Sektori i Monitorimit, Jetësimi të Prioriteteve dhe Statistikave pranë Ministrisë së Drejtësisë. Ky sektor ka koordinuar mbledhjen e kontributeve nga institucionet përgjegjëse dhe ka hartuar raportin përfundimtar.

Raporti është përgatitur sipas manualit të raportimit në sistemin IPSIS, miratuar me vendimin nr. 290, datë 11.4.2020, duke garantuar standardizimin e të dhënave dhe krahasueshmërinë ndërvite.

Periodiciteti dhe Publikimi

Ministria e Drejtësisë harton raporte gjashtëmujore dhe vjetore për monitorimin e strategjive, të cilat publikohen në faqen zyrtare të institucionit dhe shërbejnë si burim informacioni i besueshëm për politikëbërësit, institucionet përgjegjëse dhe publikun.

Raporti i monitorimit të SNMVK për periudhën janar–qershor 2025 është hartuar mbi bazën e kontributeve të institucioneve përfshirëse dhe kontributore të Planit të Veprimit.

Përputhshmëria me Parimet e Mirëqeverisjes

Raporti është ndërtuar në përputhje me Parimet e Mirëqeverisjes, të cilat përfshijnë:

- Efikasitetin, përmes shfrytëzimit të sinergjive midis dokumenteve strategjike;
- Llogaridhënien, përmes pasqyrit të progresit sipas objektivave dhe masave të planifikuara;
- Rëndësinë, përmes përshtatjes së përmbajtjes dhe frekuencës së raportimit me nevojat e përdoruesve.

Këto parime janë të harmonizuara me standardet e BE-së dhe mbështeten nga Instrumenti i Para-Anëtarësimit (IPA).

Procesi dhe Fazat e Hartimit

Hartimi i raportit ka përfshirë disa etapa kyçe:

1. Mbledhja e kontributeve – 7 korrik 2025 iu kërkuar institucioneve përgjegjëse informacion mbi ecurinë e masave.
2. Publikimi i draftit 24 shtator 2025 drafti fillestar u publikua për konsultim dhe komente nga aktorët e interesuar.
3. Konsolidimi i raportit – u reflektuan sugjerimet dhe u përgatit dokumenti final i përmirësuar.
4. Miratimi – raporti u diskutua dhe miratua në mbledhjen me institucionet përkatëse.
5. Publikimi – dokumenti përfundimtar u bë publik në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë, duke siguruar transparencë dhe akses të plotë.

Metodologjia e Analizës

Raporti përdor një kombinim metodash analitike – grafikë, tabela, dashboards dhe analiza narrative – për të reflektuar performancën e institucioneve.


Masat janë kategorizuar sipas një skeme vizuale:

- E gjelbër – masa e zbatuar plotësisht;
- E gri – masa pjesërisht e zbatuar/në proces;
- E kuqe – masa e pazbatuar;
- E bardhë – masa e pazbatueshme në këtë fazë raportimi.

Niveli i realizimit të objektivave dhe qëllimeve politike është llogaritur mbi bazën e përqindjes së masave të zbatuara kundrejt numrit total të masave të zbatueshme për secilin objektiv.

III. PROGRESI I ZBATIMIT SIPAS QËLLIMEVE

Qëllimi i Parë i Politikës: Fuqizimi i parandalimit dhe raportimit të krimit përmes informimit, ndërgjegjësimit dhe komunikimit efektiv me publikun dhe viktimave të krimit.



Arritjet kryesore:

- **Ministria e Drejtësisë:** Në kuadër të Javës së Ndërgjegjësimit për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit, zhvilluar nga Ministria e Drejtësisë gjatë datave 15-22 shkurt 2025, u organizuan një sërë aktivitetesh sensibilizuese me qëllim forcimin e bashkëpunimit ndërinstytucional dhe rritjen e ndërgjegjësimit publik. Aktivitetet u zhvilluan në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Ndhmës Juridike Falas, Qendrën e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve, si dhe me gjashtë organizata të shoqërisë civile. Gjatë javës u mbajtën 22 takime në 14 qytete të vendit, duke përfshirë aktivitete në bashkitë Berat, Korçë dhe njësinë administrative Cakran, me pjesëmarrjen aktive të të rinjve, grave dhe vajzave që i përkasin kategorisë së viktimave të krimit. Po ashtu, janë zhvilluar 7 aktivitete informuese në shkolla dhe universitete të ndryshme, ku nxënës dhe studentë morën pjesë në leksione të hapura dhe diskutime për mbrojtjen dhe riintegrimin e viktimave. Qendrat e Ndhmës Juridike organizuan edhe një sërë aktivitetesh ndërgjegjëse në shkolla të tjera në Korçë, Tropojë, Shkodër dhe Dibër, si dhe pesë takime të drejtpërdrejta me viktimat e krimit. Një kontribut të veçantë dha rinia dhe vullnetarët përmes stendës informuese pranë Ministrisë së Drejtësisë, ku shpërndanë materiale ndërgjegjëse dhe mbështetën edukimin ligjor të qytetarëve. Gjithashtu, punonjësit e qendrave të ndihmës juridike realizuan edhe aktivitete të tipit *Street Law*, të fokusuara në informimin e viktimave të krimit mbi të drejtat e tyre dhe aksesin në drejtësi.
- **Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale:** Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ndërmori një sërë aktivitetesh të rëndësishme për fuqizimin e mekanizmave të mbrojtjes së viktimave dhe avancimin e barazisë gjinore. Më 6 janar u zhvillua trajnimi i dytë për dy specialistë të Sektorit të Barazisë Gjinore mbi përdorimin e platformës REVALB, duke përfshirë njohuritë dhe përcaktuar detyra të qarta për monitorim të rregullt të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit. 10 deri më 12 qershor, u trajnuan 61 Koordinatorë Vendorë të Dhunës në Familje nga të gjitha bashkitë e vendit për të rritur kapacitetet e tyre në përdorimin e kësaj platforme. Në kuadër të përpjekjeve për ndërgjegjësim dhe promovim të barazisë, Ministria organizoi në bashkëpunim me UN Women dhe me mbështetjen e Qeverisë Suedeze dhe BE-së, aktivitetin “Tre Dekada Ndryshimi për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave”, që adresoi sfidat dhe prioritetet e vendit në këtë fushë në kontekstin e integritimit evropian. Gjithashtu, më 28 mars u mbajt takimi “Gratë në Politikë dhe Zgjedhje”, ku u diskutuan sfidat e përfaqësimit dhe dhuna ndaj grave në politikë. Më 19 qershor, në Ostren të Bashkisë Bulqizë, u organizua një takim për prezantimin dhe shkëmbimin e modeleve të mira në kuadër të projektit për fuqizimin ekonomik dhe social të grave në zonat rurale, duke kontribuar në rritjen e përfshirjes dhe zhvillimit të tyre në komunitet.
- **Avokati i Popullit:** Organizoi 30 aktivitete “ditë të hapura” në shkolla për të drejtat e fëmijëve; realizoi veprimtari advokacie dhe lobimi me institucione arsimore dhe OJF; mundësoi ngritjen e zërit të fëmijëve mbi problematikat e tyre.
- **Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD):** Mori pjesë aktive në tryeza ndërinstytucionale për viktimat e krimit; organizoi aktivitete ndërgjegjëse në Fier, Korçë dhe bashki përreth; kontribuo në hartimin e Planit Vendor për Barazi Gjinore 2025–2030.
- **Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ):** Siguroi respektimin e të drejtave të viktimës sipas Kodit të Procedurës Penale; garantoj mjedise të aksesueshme dhe të sigurt në gjykata.
- **Prokuroria e Përgjithshme (PP):** Janë hartuar dhe publikuar, Letra e të Drejtave të Viktimës dhe Letra e të Drejtave të Viktimës së Mitur; draftoi materiale të reja për viktimat e trafikimit; garantoj shërbim gatishmërie për prokurorët 24/7.
- **Policia e Shtetit:** Ngriti 15 njësi miqësore për intervistimin e të miturve; hapi qendra për trajtimin e viktimave të krimeve seksuale në Shkodër dhe Fier; punësoi 22 psikologë në strukturat vendore; specialistët e hetimit trajtojnë rastet e dhunës në familje 24/7.


- **Drejtoria e Ndihmës Juridike (DNJ)**: Realizoi 273 aktivitete ndërgjegjësuere (173 për viktimat e krimit); ofroi shërbime ligjore për një gamë të gjerë çështjesh sociale e familjare; përgatiti manual në Braille dhe materiale video me titra/audio për aksesueshmëri; zhvilloi 27 aktivitete gjatë javës së viktimave të krimit.
- **Qendra “Të Ndryshëm & Të Barabartë” (D&E)**: Ofruan ndihmë juridike parësore për 121 qytetarë dhe dytësore për 25 raste gjyqësore; linja e këshillimit u përdor në 190 raste; organizuan 4 aktivitete sensibilizuese gjatë javës së viktimave; zhvilluan 11 sesione informimi në shkolla e komunitet; publikuan informacion të vazhdueshëm në rrjetet sociale.
- **Qendra “Vatra”**: Realizoi mbi 72 takime informimi në shkolla me 1810 të rinj; zhvilloi 9 sesione informimi në shkolla 9-vjeçare dhe të mesme; shpërndau informacion përmes Website-it dhe rrjeteve sociale; realizoi aktivitete ndërgjegjësuere gjatë javës së viktimave të krimit, përfshirë fletëpalosje dhe pjesëmarrje në media lokale; siguroi trajnime për stafin dhe monitorim të shërbimeve.
- **Bashkia Durrës**: Finalizoi bashkëpunimin me ofruesit lokalë të shërbimeve kundër dhunës me bazë gjinore; realizoi fushata sensibilizuese me partnerë lokalë dhe OJF.

Hapat në vijim:

- Zgjerimi i programeve advokuese dhe fushatave ndërgjegjësuere edhe në nivel komuniteti dhe në zona rurale.
- Hartimi i udhëzuesve praktikë për adresimin e shqetësimeve të fëmijëve dhe grupeve vulnerabël.
- Konsolidimi i Mekanizmave Lokale të Referimit dhe forcimi i partneritetit me shkolla, polici dhe shërbimet sociale.
- Përmirësimi i kushteve logjistike dhe standardeve të mjediseve miqësore ndaj viktimave në gjykata, prokurori dhe polici.
- Sigurimi i përkthyesve të specializuar për viktimat e huaja.
- Rritja e përdorimit të platformave online për informim, këshillim dhe referim të rasteve.
- Zgjerimi i fushatave edukative në shkolla dhe komunitete mbi dhunën, trafikimin dhe të drejtat e viktimave.
- Përmirësimi i mekanizmave të monitorimit dhe vlerësimit të shërbimeve sociale dhe rezidenciale.

II. Qëllimi i Dytë i Politikës

Një kuadër ligjor i përafëruar me standardet e parashikuara në direktivat e Bashkimit Evropian dhe aktet ndërkombëtare të tjera, institucione dhe profesionistë që ofrojnë mbështetje, mbrojtje efektive për viktimat e krimit dhe akses të drejtë të viktimës në një skemë kombëtare të kompensimit



Arritjet kryesore:


- **Prokuroria e Përgjithshme:** Siguroi bashkëpunim efektiv me INSTAT për raportime statistikore; Janë zhvilluar trajnime sipas tematikave të propozuara nga SHM trajnime për mbrojtjen e viktimave vulnerabël si dhe pjesëmarrje në konferenca rajonale mbi drejtësinë restauruese.
- **INSTAT:** Gjatë shkurt–mars 2025 realizoi mbledhjen dhe transmetimin e të dhënave mbi viktimat e vrasjeve me dashje dhe trafikimit, sipas kërkesave të Eurostat dhe UNODC; në prill 2025 publikoi botimin “Statistikat e krimeve dhe drejtësisë penale 2025”. Gjithashtu, mori pjesë në takimin rajonal të Eurostat në Luksemburg mbi pyetësin UN-CTS.
- **Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve (DPB):** Nga një proces vlerësimi, 26 të burgosur kanë vetëdeklaruar se kanë qenë viktimë krimi; të dhënat publikohen rregullisht në faqen zyrtare të DPB.
- **Policia e Shtetit:** Hartoi programin mësimor vjetor për trajnimin e detyrueshëm në shërbim; ngriti grup pune për vlerësimin e krijimit të funksionit të dedikuar për trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe të miturve. Në bashkëpunim me OJF-të zhvilloi trajnime mbi hetimin e krimeve, angazhimin me të rinjtë në rrezik dhe praktikat evropiane. Në gjashtëmujorin e parë 2025 realizoi 12 trajnime me 130 pjesëmarrës mbi intervistimin e viktimave të trafikimit.
- **Bashkia Durrës:** Përshtati sistemin REVALB me rastet e reja të dhunës në familje/dhunës me bazë gjinore; publikoi Planin Social 2025–2028 dhe protokollet e menaxhimit të rasteve me qasje shumësektoriale; përditësoi Planin Vendor për Barazinë Gjinore 2023–2025; hartoi paketën ligjore për Njësinë e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit.
- **Qendra “Vatra”:** Zhvilloi trajnime me prokurorë dhe gjyqtarë në gjashtë juridiksione të vendit; forcoi bashkëpunimin me Shërbimin Ligjor Falas dhe OJF-të për lehtësimin e informimit të viktimave mbi aplikimin për kompensim.
- **Aktivitetet e shoqërisë civile:** Shoqata “Gender, Paqe dhe Siguri” zhvilloi fushata ndërgjegjëse në partneritet me policinë dhe aktorët vendorë.

Hapat në vijim:

- Finalizimi i procesit të digjitalizimit të sistemit statistikor të prokurorisë dhe integrimi i tij me sistemet e tjera shtetërore.
- Forcimi i kapaciteteve për vlerësimin dhe asistimin e viktimave përmes trajnimeve të reja për ekspertët vlerësues, psikologë dhe punonjës socialë.
- Zbatimi i paketës ligjore për Njësitë e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit në nivel vendor dhe forcimi i bashkëpunimit ndërinstytucional.
- Vlerësimi dhe funksionalizimi i plotë i rolit të specialistit të dedikuar në polici për trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe të miturve.
- Rritja e bashkëpunimit ndërmjet INSTAT, Prokurorisë dhe Policisë për sigurimin e statistikave më gjithëpërfshirëse dhe të krahasueshme në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.
- Zhvillimi i fushatave të reja të ndërgjegjësimit dhe programeve të trajnimit në partneritet me shoqërinë civile dhe organizatat ndërkombëtare.

III. Qëllimi i Tretë i Politikës

Garantimi i të drejtës për informim, mbështetje dhe mbrojtje të viktimave në proceset penale dhe njohja e viktimave me nevoja mbrojtjeje të veçantë



Arritjet:

- **Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale:** Gjatë vitit 2025, u zhvilluan iniciativa të rëndësishme për mbështetjen e viktimave dhe barazinë gjinore. FRA prezantoi raportin për reagimin ndaj viktimave të krimit në BE. Ministria e Shëndetësisë dhe UNDP organizuan takime për përforcimin e bashkëpunimit të Mekanizmave Kombëtar të Referimit në trajtimin e dhunës në familje. Në Shkup u mbajt Konferenca Rajonale për avancimin e grave dhe mekanizmat e koordinuar të referimit. U organizuan trajnime për koordinimin dhe raportimin e rasteve në sistemin REVALB. Përmes Fondit Social, mbështeten tre strehimore rajonale, dy linja këshillimi, një qendër për LGBTI dhe shërbime për viktimat e dhunës dhe trafikimit, duke përfshirë mbi 400 përfitues.
- **Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ):** Garantimi i të drejtave të viktimës gjatë procesit penal si pjesë e veprimtarisë së gjyqtarit, në përputhje me Kodin e Procedurës Penale (K.Pr.Penale). Gjatë vlerësimit të gjyqtarëve mban në vëmendje orientimin drejt zgjidhjeve

alternative (ndërmjetësimit). Krijimi i sistemit të komunikimit të pikëzimit...” (VKM nr. 264, datë 21.11.2019); në portalin gjykata.gov.al është publikuar video informuese për ndërmjetësimin. Masa për informimin dhe mbrojtjen e viktimave e realizuar për periudhën raportuese.

- **Policia e Shtetit:** Urdhri nr. 367, datë 19.02.2024 i DPPSh “Për respektimin dhe garantimin e të drejtës për t’u informuar...” (përfshin **Letrat e të Drejtave** për të mitur autorë/viktima/në konflikt me ligjin; persona të shoqëruar; viktima të dhunës në familje). Letrat e të Drejtave **të përkthyer në 9 gjuhë:** anglisht, italisht, frëngjisht, rusisht, serbokroatisht, gjermanisht, arabisht, polonisht, greqisht. Detyrimi i punonjësve të policisë për të **informuar viktimat** mbi shërbimet mjekësore, psikologjike dhe juridike. Notifikim i menjëhershëm i **Koordinatorëve Vendorë** të dhunës pranë bashkive; prania e **detyrueshme e PMF/NJMF** në rastet me të mitur. Ngritje e **Njesisë Lëvizëse** (Pogradec, prill 2025) në kuadër të MKR-së, për identifikim proaktiv dhe referim të viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit (me mbështetjen e GIZ).
- **Prokuroria e Përgjithshme (PP):** Zbatimi i vazhdueshëm i detyrimit për **informimin efektiv** të viktimës nga prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore; adresim i temave të informimit në udhëzime, qarkore dhe programe trajnimi. Kuadër i plotë nënligjor për asistencën ndaj viktimave:
 - Udhëzimi i Përgjithshëm nr. 5/2018 (e drejta për informim/mbështetje/mbrojtje; neni 24 & 30 mbi njoftimin e të drejtës së ankimit; neni 26 për dëmshpërblimin nga i pandehuri).
 - Udhëzimi nr. 17/2020 (hetimi i dhunës ndaj grave, dhunës në familje dhe me bazë urrejtje).
 - Udhëzimi nr. 6/2024 (hetimi i veprës penale të **trafikimit të personave**; detyrim për ngritje kapacitetesh për identifikimin e viktimave/viktimave të mundshme).
 - Udhëzimi nr. 4, datë 10.06.2025 (“Rekomandimet prioritare 2025...”) për garantimin me kujdes të **garancive procedurale** ndaj viktimave.

Koordinatorët e viktimave asistojnë në informim mbi procesin, të drejtat dhe shërbimet, me gjuhë të qartë dhe miqësore. Në proces: vlerësimi I mundësive ligjore mbi harmonizimin e udhëzimit nr. 5/2018 me dokumentin udhëzues të DG JUSTICE (transpozimi i Direktivës 2012/29/BE). Pjesëmarrje në aktivitete/trajnime: tryezë mbi zbatimin e legjislacionit kundër dhunës me bazë gjinore (me UN Women & Nisma për Ndr. Ligjore); konferenca/raporte analitike (raporti vjetor 2024—hartuar mars 2025) mbi efektivitetin e hetimeve dhe politikës penale; simulim OSBE 3-ditor mbi masat kundër trafikimit (4 koordinatorë pjesëmarrës). Lista e përkthyesve mbahet dhe përditësohet periodikisht në çdo prokurori.

- **Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas (DNJF) Informim në pikën e kontaktit:** qendrat e shërbimit kanë të gjitha materialet për të drejtat e viktimave në momentin e paraqitjes; fletëpalosje/postera me fokus viktimat e krimit. Aksesueshmëri: manual në Braille “Si të përfitojmë ndihmë juridike”, udhëzues mbi komunikimin me kategori të veçanta; video informuese me audio/titra (“Çfarë është ndihma juridike falas...”) në ëeb/rrete sociale. **20** Qendra të ndihmës juridike falas funksionale në 2025, me buxhet shteti (ofrues parësorë dhe OJF të autorizuar; dytësor sipas procedurave DHKA/DNJF). Udhëzimi i përbashkët DHKA–DNJF nr. 1, datë 15.2.2023: kriteret e reja për avokatët e listës (preferohen të trajnuar për të mitur, DV, trafikim, etj.).

Statistika Janar–Qershor 2025:

- Ndihmë juridike **parësore** për **554 viktima** (483 dhunë në familje; 7 abuzim seksual; 64 trafikim).
- Ndihmë juridike **dytësore** për **84 viktima** (kryesisht dhunë në familje).
- **273 aktivitete** ndërgjegjësuere/informuese (173 me fokus viktimat e krimit); përfshin informimin për **rimbursimin** dhe kriteret ligjore.

Analizat statistikore mujore **publikohen** në ndihmajuridike.gov.al.Ligji 111/2017 parashikon viktimat (DV, dhunë seksuale, trafikim, të mitur) si **kategori të veçantë** me të drejtë për ndihmë të menjëhershme.

- **Ministria e Brendshme:** 6 takime (mars–maj 2025) në 6 qarqe me ~50 përfaqësues (inspektorati i punës, shërbimi social shtetëror, PMF, sektorët e trafiqeve/ dhunës në familje në polici): identifikimi i problematikave (trafikimi i fëmijëve, shfrytëzimi i të huajve), forcimi i bashkëpunimit lokal dhe koordinimi i mbështetjes për viktimat.Ëorkshop 2-ditor (prill 2025) me ~20 përfaqësues (ASHMDF, MD, sektorë hetimi trafiqesh në polici, AKPA) për PSV (procedura standarde veprimi) për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit.Njësi Lëvizëse e re në Pogradec (prill 2025) me mbështetjen e GIZ: identifikim proaktiv dhe referim, duke zbatuar PSV/standartet e njësive lëvizëse.
- **Bashkia Durrës:** Raportim periodik (çdo 3 muaj / 6-mujor / vjetor) te ASHDMF, KRAT dhe brenda institucionit.Në proces: plotësimi me punonjës përgjegjës në NJVNR për njësitë administrative Ishëm & Manëz; sistemi i referimit për të miturit funksionon me GTN (grupi teknik ndërsektorial).7 Qendra Komunitare Multifunksionale—shërbime edhe për viktimat e dhunës.Trajnime të vazhdueshme për PMF, koordinatore vendorë kundër dhunës dhe punonjës socialë (identifikim, menaxhim rastesh, VT/VMF).Menaxhim rasti me vlerësim risku (me policinë), vlerësim nevojash, PIM dhe monitorim të ofrimit të shërbimeve; zbatim në vijimësi i PSV për vlerësim/menaxhim viktimash; monitorim i urdhrave të mbrojtjes.
- **Zyra e Komisionerit për të Dhënat Personale:** Në kuadër të Marrëveshjes me Eurojust, gjatë periudhës raportuese: 6 monitorime pranë PP (Prokuroria e Përgjithshme, Tiranë, Fier, Gjirokastrë, Shkodër) dhe SPAK—zbatimi i ligjit nr. 124/2024 dhe verifikimi i përpunimit të të dhënave personale. Dy raporte monitoruese të përfunduara (për PP Tiranë dhe PP Fier). 5 hetime administrative mbi risitë e Direktivës së Policisë në Drejtorinë e Shërbimit të Provës & degët Elbasan, Vlorë, Korçë, Shkodër; Rekomandim nr. 24 (30.05.2025) për DPShP.2 hetime administrative në qendrat për viktimat e trafikimit (për mbrojtjen e të dhënave sensitive); Rekomandim nr. 03 (25.02.2025) për Qendrën Psiko-Sociale Vatra dhe Rekomandim nr. 04 (03.03.2025) për “Shoqata Tjetër Vizion”.
- **Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA):** Monitorim i përmbajtjeve audiovizive për respektimin e dinjitetit dhe të drejtave të viktimave (sidomos të miturve); thirrje sensibilizuese dhe udhëzime publike për raportim etik/profesional në përputhje me standartet ndërkombëtare dhe ligjin kombëtar.


Hapat në vijim:

- Përditësim/plotësim i udhëzimeve dhe akteve të brendshme për ta sjellë zbatimin plotësisht në linjë me Direktivën 2012/29/BE dhe standartet për mbrojtjen e viktimave.
- Sigurimi i përkthyesve dhe interpretëve të gjuhës së shenjave me mekanizma kontraktualë të qëndrueshëm dhe disponibilitet 24/7.
- Zgjerimi i njësive lëvizëse dhe i modeleve proaktive të identifikimit/referimit në të gjithë qarqet; standardizimi i PSV dhe i praktikave të ndërmjetësimit.
- Unifikimi i protokolleve të menaxhimit të rastit (vlerësim rreziku, PIM, ndjekje/monitorim), me supervizim periodik cilësor.
- Rritja e kapaciteteve për të gjithë profesionistët në zinxhir (trajnim i vazhdueshëm, module të përbashkëta, simulime ndër-institucionale).

- Forcimi i shkëmbimit të Krimit 2024-2030 dhe i interoperabilitetit të sistemeve, për raportim të rregullt, të sakte dhe të krahasueshëm.
- Zgjerim i bashkëpunimit me OSHC/partnerë ndërkombëtarë për mbështetje psiko-sociale, strehim emergjent dhe rritje ndërgjegjësimi publik

IV. Qëllimi i Katërt i Politikës

Forcimi i bashkëpunimit dhe koordinimit mes aktorëve që veprojnë në fushën e mbrojtjes së viktimave të krimit në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar



Arritjet:

- **Avokati i Popullit:** Regjistroi raste ankesash lidhur me të mitur, viktimë krimi (janar–qershor 2025) – në proces shqyrtimi/hetimi administrativ. Me inisiativë trajtoi një rast të publikuar në media (doc nr. 202501250, “pornografia” ndaj një të mituri) dhe adresoi rekomandime: monitorim i vazhdueshëm nga NJF në bashki; bashkërendim i mekanizmave vendorë për mbështetje/ fuqizim të familjes. AP monitoron periodikisht zbatimin e rekomandimeve dhe raporton në Kuvend. Observatori (me mbështetje UN Eëomen): metodologji e përshtatur (kuadri statistikor i OKB) – përveç vrasjeve të grave/vajzave përfshin edhe vrasjet e mbetura në tentativë, plagosje e rëndë me dashje (neni 88) dhe shkaktim i vetëvrasjes (neni 99) gjatë 2024; të dhënat hidhen në databazë të dedikuar dhe përdoren pyetësorë të posaçëm. Parime: konfidencialitet, mbrojtje e të dhënave personale/sensitive. Raporti special “Vrasjet e grave dhe vajzave dhe femicidi në Shqipëri, 2021–2023” (lançuar më 10 dhjetor 2024, dërguar Kuvendit në shkurt 2025). 5 rekomandime të adresuara te KLGJ, KLP, DPP, MSHMS dhe të gjitha bashkitë – për forcimin e rolit të tyre ndaj dhunës në familje/dhunës me bazë gjinore & femicidit. Janar–Qershor 2025: vijon mbledhja e të dhënave për Raportin Vjetor 2024 (vrasje/femicide, vetëvrasje, tentativa, plagosje e rëndë).
- **Ministria e Brendshme:** 1 takim i anëtarëve të MKR (periudha raportuese) – u prezantua draft-PSV për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit. Takime të Autoritetit Përgjegjës për asistimin në kthimin vullnetar të një viktime.
- **Bashkia Durrës:** Kuadër ligjor i konsoliduar dhe i përmirësuar; protokollet e standardizuara të MSHMS për menaxhimin e rasteve (periudhë normale/pandemi/dhunë seksuale) njihen nga anëtarët e mekanizmit. MKR-të janë ngritur në të gjitha bashkitë; rrjeti i koordinatorëve vendorë funksional për referim ndërbashkiak (viktimat shpesh lëvizin nga një qytet në tjetrin). 23 raste të Dhunës në Familje të referuara pranë Bashkisë Durrës. 22 raste të pajisura me UMM–UM të referuara pranë NJVNR për vlerësim dhe monitorim. 8 monitorime UM dërguar pranë DVP Durrës. 2 mbledhje të Ekipit Teknik Ndërdisciplinar (ETN). Hartuar Plani i Punës i MKR për vitin 2025. Përditësim i sistemit REVALB me rastet e dhunës në familje. Organizim

- takimesh të ETN për trajtimin/menaxhimin e rasteve. NJM Fëmijë (NJMf): 60 raste të reja të menaxhuara (VMT; probleme socio-ekonomike; dhunë; bashkëpunim me Zyrën e Përmbarrimit/ Shërbimin e Provës; fëmijë në situatë ruge; konflikt me ligjin; regjistrim gjendje civile; mbështetje sociale/ligjore; sistemim në qendra rezidenciale, etj.). Trajnime me punonjësit socialë të NJ.V.R.N për menaxhimin e rasteve të dhunës në familje. Pjesëmarrje në tryezë të rrumbullakët advokacie me MKR të Dhunës ndaj Vajzave dhe Grave; Takimi i rrjetit të koordinatorëve vendorë (qershor 2025); mbledhje e ETN; pjesëmarrje në mbledhjen e GTN për të miturit. Marrëveshje me institucione aktorë lokalë; pjesëmarrje në takime (edhe online), p.sh. prezantimi i projektligjit për identitetin gjinor (Pink Embassy). Bashkëpunim me shërbime
- mbështetëse (Linja e Këshillimit për Gratë dhe Vajzat; qendra mbrojtëse/fuqizuese/emergjente për fëmijën & familjen; qendra strehimi “Edlira Haxhiymeri”; qendrat komunitare “Sot për të ardhmen”, “Qendra e Reziliencës”, Nishtulla, Rrashbull; ARSIS (strehë emergjente); ALO 116 111 për fëmijë, etj.). Vlerësim rreziku (me policinë); vlerësim i nevojave; hartim dhe zbatim PIM; monitorim i ofrimit të shërbimeve; zbatim në vijimësi i PSV; bashkëpunim i ngushtë për monitorimin e urdhrave të mbrojtjes. Në proces, riorganizimi i kapaciteteve të profesionistëve që punojnë me/për viktimat (të drejta, trajtim rreziqesh, mbrojtje specifike).
- **AMSHC (Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile):** Regjistër me vetë-regjistrim i OSHC-ve: 685 OJF të regjistruara (në databazën e AMSHC-së); 38 me fokus barazi gjinore / fuqizim i gruas / lufta kundër dhunës ndaj grave & dhunës në familje (5.5%). Fokuset kryesore: barazia gjinore; fuqizimi i grave; stimulim/fuqizim i sipërmarrjes femërore (p.sh. artizanat); mbështetje për gra, fëmijë, të rinj, komunitete; formim profesional; lobim për target-grupet. Do të dërgohen kërkesa zyrtare për informacion të aktorët publikë/jopublikë për hartëzim/përditësim të shërbimeve mbështetëse (për të gjitha kategoritë e viktimave, përfshirë programe drejtësie restauruese & ndërmjetësimi; vënia në dispozicion e profesionistëve). Thirrja nr. 18 për projekt-propozime (13.05–13.06.2025); një nga prioritetet – përfshirja sociale, të drejtat e njeriut, fuqizimi i grupeve të marginalizuara. Statistikat do raportohen pas mbylljes së vlerësimit/shpalljes së fituesve.
- **Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD):** Raportim vjetor & periodik para Kuvendit (sipas Vendimit nr. 134/2018), për zbatimin e ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi” dhe statusin e rekomandimeve ndaj ekzekutivit/agjencive në varësi. Shkresa nr. 1617/3, datë 27.12.2024 me rekomandime për projektligjin “Për vullnetarizmin”:
 - si përfitues të vullnetarizmit të mbahen në vëmendje edhe viktimat e diskriminimit;
 - si të ndaluar për angazhim, shtesa e personave të gjendur në shkelje të barazisë/mosdiskriminimit me vendim gjykate të formës së prerë ose organi publik kompetent. Projektligji është dërguar për bashkërendim dhe rekomandimet e KMD janë reflektuar.

Hapat në vijim:

- Konsolidimi i MKR në të gjitha nivelet: harmonizim praktik i PSV, unifikim i protokolleve të menaxhimit të rastit (vlerësim rreziku, PIM, ndjekje/monitorim) dhe rritje e supervizimit cilësor.
- Hartëzim i plotë dhe përditësim periodik i shërbimeve mbështetëse dhe profesionistëve (përfshirë drejtësinë restauruese/ndërmjetësimin), me publikim në një platformë të aksesueshme.
- Rritje e kapaciteteve (trajnim i vazhdueshëm) për koordinatorë vendorë, punonjës socialë, PMF, ekipet teknike ndërdisiplinare dhe stafet në pikë-kontakti.

- Forcimi i rrjeteve me OSHC-të dhe partnerët ndërkombëtarë, me mekanizma të qartë bashkë-financimi dhe referimi.
- Përmirësimi i shkëmbimit të të dhënave (integrim me regjistra ekzistues; përdorim i standardeve statistike; raportim i rregullt treguesish të përbashkët).
- Vazhdimësi e takimeve (ETN/GTN/rrejtë i koordinatorëve) dhe e fushatave të përbashkëta të advokacisë/informimit në nivel kombëtar e lokal.

Rekomandime

Në vazhdim të analizës, hapat vijues përqendrohen në sigurimin e një zbatimi të plotë dhe efikas të masave të Strategjisë Ndërsektorale të Mbrojtjes së Viktimave të Krimit gjatë periudhës së ardhshme raportuese, me synimin për të shmangur risqe të reja që mund të ndikojnë në reformën në drejtësi. Për këtë qëllim, do të ndërmerren hapat e mëposhtëm:

1. Përmirësimi i mekanizmave të raportimit dhe monitorimit

- Organizimi i workshopeve të specializuara për rritjen e kapaciteteve të raportimit nga institucionet përgjegjëse.
- Përditësimi i metodologjisë së raportimit për të siguruar një analizë më të thelluar të të dhënave dhe të ndikimit të strategjisë.

2. Zhvillimi i mekanizmave të parandalimit të risqeve

- Krijimi i një mekanizmi paralajmërues të hershëm për të identifikuar dhe adresuar në kohë sfidat që mund të ndikojnë në zbatimin e strategjisë.
- Hartimi i rekomandimeve për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe institucional, bazuar në analizën e sfidave të raportuara.

3. Forcimi i kapaciteteve institucionale për implementimin e strategjisë

- Organizimi i trajnimeve për stafin përgjegjës për monitorim dhe zbatim
- Organizimi i workshopeve të specializuara për rritjen e kapaciteteve të raportimit buxhetor nga institucionet përgjegjëse.

4. Përmirësimi i koordinimit ndërinstitutional

- Zhvillimi i takimeve të rregullta mes institucioneve kyçe për të garantuar një qasje të unifikuar dhe efektive në zbatimin e strategjisë.
- Rritja e transparencës në ndarjen e informacionit ndërmjet institucioneve dhe përmirësimi i mekanizmave të raportimit të përbashkët.

Këta hapa do të sigurojnë një zbatim më efikas, të qëndrueshëm dhe të koordinuar të Strategjisë duke minimizuar risqet dhe garantuar përparim të qëndrueshëm.